# Statistika per Pyjet

(**Pyjet dhe Kullotat**)

Pyjet dhe kullotat mbulojne rreth 1,5 milion hektare ose 52% te siperfaqes totale te Shqiperise.Mbeshtetur ne te dhenat kadastrale te vitit 2005, pyjet mbulojne 1.043 mije hektare ose 36% te siperfaqes totale, e cila eshte klasifikuar,

ne pyje te larte (Trungishte) 458 mije hektar,
ne pyje te ulet (Cungishte) 325 mije hektar dhe
shkurre 260 mije hektare.

**Duke iu referuar formave te pronesise**,

pyjet shteteror jane 690 mije hektare,
pyje komunal 336 mije hektare dhe
pyje privat 17 mije hektare.

Sipas statistikave te vitit 2005 prodhimtaria e pyjeve te Shqiperise vleresohet mestarisht 78 m3 per ha, shifer e cila konsiderohet shume e ulet. Gjithashtu prodhimtaria e pyjeve shteteror eshte vleresuar rreth 97 m3 per ha, ajo e pyjeve komunal 39 m3/ha dhe ne pyjet privat prodhimtaria eshte vleresuar rreth 58 m3/ha.

Kullotat ne shqiperi zene nje siperfaqe rreth 416 mije hektare, e cila perbehet nga:

| | | |
|---|---|---|
| *KULLOTA SHTETERORE* | *138388* | *34 %* |
| *KULLOTA KOMUNALE* | *238301* | *57 %* |
| *KULLOTA PRIVATE* | *37863* | *9 %* |

***KULLOTA SHTETERORE***

| Nr. | Emertimi | Njesia | Ndar sipas tipit te kullotave<br>**Dimerore**<br>Shteterore | **verore** | **gjithesej** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **SIPERFAQJA KULLOSORE** | | | | |
| 1.1 | E shfrytezueshme | Ha | 28913.7 | 91997 | 120910.7 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.2 | E pa shfrytezueshme | Ha | 2892.8 | 14585.2 | 17478 |
| 1.3 | **Gjithsej** | **Ha** | **31806.5** | **106582.2** | **138388.7** |
| 2 | **KAPACITETI KULLOSOR** | | | | |
| 2.1 | Dhen | Krere | 96199 | 433580 | 529779 |
| 2.2 | Dhi | Krere | 41503 | 24934 | 66437 |
| 2.3 | Kafshe te trasha | Krere | 1249 | 5080 | 6329 |
| 2.4 | **Gjithsej** | **Krere** | **138951** | **463594** | **602545** |

Nga të dhënat kadastrale te disa dekadave, rezulton se siperfaqja e fondit kullosor në vitin 1950 ishte rreth 816 mije hektarë, ndërsa sipas te dhenave te kadastres se vitit 2004, siperfaqja kullotave dhe livadheve eshte rreth 416 mije hektarë, ose 16 % e siperfaqes totale te vendit.
Zvogelimi i kesaj siperfaqeje eshte rrejdhoje e vendimeve e politikave te ndjekura nga qeverite e mëparshme, mbi menyren e perdorimit te teritorit ne Shqiperi.

Tab.1

| Struktura e siperfaqes (ne 1000 ha) | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Emertimi** | **1950** | **1990** | **1995** | **2002** |
| Toke Bujqesore | 391 | 704 | 702 | 701 |
| Pyje | 1282 | 1045 | 1052 | 1057 |
| Kullota e livadhe | 816 | 417 | 428 | 416 |
| Te tjera | 386 | 709 | 693 | 701 |
| SIPERFAQJA, GJITHSEJ | 2875 | 2875 | 2875 | 2875 |

Megjithkete kapaciteti aktual kullosor, vleresohet te jete shume me i ulet, rreth 0.9 Njesi ekivalente /ha/vit, duke sugjeruar se ngarkesa e tanishme e blegtorise ne kullotat eshte te pakten 4 here me e larte se kapaciteti i tyre kullosor(ANFI). Nje mbikullotje e tille perben nje pasoje serioze jo vetem per kullotat por gjithashtu edhe per produktivitetin e blegtorise perderisa rendimentet mesatare te qumeshtit nga delet, dhite dhe lopet jane shume me te ulta se nivelt Europiane.

Dendesia e numurit te krereve arrin rreth 4.35 Njesi ekivalente /ha/vit, neqoftese merren vetem delet, ose 6.84 neqoftese perfshihen te dhirtat ose 15.0 Njesi ekivalente /ha/vit neqoftese shtojme edhe gjedhin. Keto dendesi

jane shume me te larta se kapaciteti kullosor prej 3.66 Njesi ekivalente /ha/vit sic pranohet zyrtarisht.

Sipas periudhes se shfrytezimit kullotat natyrore ndahen si vijon:

| Nr. | Treguesi | Viti 2004 | |
|---|---|---|---|
| | | **Siperfaqe (ha)** | **%** |
| **A** | **Sipas tipit te kullotes**<br>1. Kullota verore<br>2. Kullota dimerore<br>3. Gjithesej | <br>291 465<br>124 446<br>415 911 | <br>70<br>30<br>100 |
| **B** | **Sipas llojit te pronesise**<br>1. Kullota shteterore<br>2. Kullota Komunale<br>3. Kullota private<br>4. Gjithesej | <br>144 077<br>241 523<br>30 311<br>415 911 | <br>34,6<br>58,2<br>7,2<br>100 |
| **C** | **Nr. Krereve sipas llojeve**<br>1. Te leshta<br>2. Te dhirta<br>3. Te trasha<br>4. Gjithesej<br>5. Te konvertuara | <br>1 237 813<br>200 413<br>16 605<br>1 454 831<br>1 521 251 | |

**Kapaciteti mbajtes 3,6 krere/ha**